



## DREJTORATI I INSPEKSIONIT

<b>Datë :</b>	<b>03.04.2026</b>
<b>Referencë</b>	<b>11-344/3</b>
<b>Për :</b>	<b>Imri Ahmeti-Kryetar i Komunës</b>
<b>Kopje:</b>	<b>Diamant Bytyqi-Nënkryetar i Komunës</b>
<b>Nga:</b>	<b>Flamur Sylejmani-Drejtori i Inspeksionit</b>
<b>Lënda :</b>	<b>Raporti i muajit-mars</b>

### PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Gjatë muajit mars Drejtoria e Inspektoratit ka ndjekur agjendat e caktuara dhe ka realizuar inspektime të ndryshme në kuadër të kompetencës, duke përfshirë të gjitha lokalitetet në territorin e Komunës tonë.

Inspektori i mjedisit-ambientit- Janë bërë inspektime sipas ankesave të pranuar në sektorin e mjedisit. Ankesat ishin për ndotje të mjedisit me mbeturina të shkaktuar nga qytetarë dhe biznese, pastaj ankesa për mbyllje të pusetave të kanalizimit, ngushtim të shtratit të lumit, për zhurmë, për ndotje aksidentale të rrugës me vajra motorike etj. Në të gjitha inspektimet e bëra janë dhënë urdhëresa me procesverbal për sanimin e gjendjes, janë shqiptuar 4 gjoba mandatore për ndotje të mjedisit me mbeturina. dhe po ashtu janë bërë rikontrolla për të verifikuar zbatimin e urdhëresave. Është inspektuar KRM Pastrimi, për shkak të grumbullimit të një sasive të konsiderueshme të mbeturinave në vendin e quajtur pika e transferit të mbeturinave, zona kadastrale f.sh Grackë e Vjetër. Kompanisë në fjalë i është dhënë urdhëresë për largimin e të gjitha mbeturinave dhe mos

të shfrytëzohet ky vendi për grumbullim të mbeturinave. Operatori është duke larguar mbeturinat, duke i dërguar në deponin regjionale në Mirash.

Janë bërë kontrollat tek objektet banesor në ndërtim e sipër në Lipjan, objektet në Rr. “Tahir Sinani” Rr. “Haxhi Klecka” Rr. “Sadik Shala” në lidhje me zbatimin e kushteve të lejes mjedisore komunale, gjatë kontrolleve janë dhënë urdhëresa për grumbullim të mbeturinave në vende punishte dhe vendosje të tyre në kontejner.

Sipas ankesave të pranuar rreth problemeve me grumbullimit të mbeturinave në fshatra, nga KRM Pastrimi, është dalë në teren dhe është verifikuar se KRM Pastrimi nuk është duke i marrë mbeturinat me kohë nëpër fshatra për shkak të mungesës së mjeteve transporti. Është bërë raport për gjendjen në teren dhe i është dërguar kryetarit si njoftim.

Janë inspektuar deponit ilegale të mbeturinave për të marrë masa ligjore ndaj atyre që takohen apo gjeten dëshmi për ndotje të mjedisit

Inspektorët e trafikut- objektivë e inspektoreve të trafikut ka qenë inspektimi i kompanive të autobusëve, auto-taksive si dhe kombi-taksi ilegal.

Firmat e autobusëve janë inspektuar për çertifikata të autobusëve dhe për rende të udhëtimit se a janë të pajisur si dhe a janë duke e respektuar rendin e udhëtimit

Janë bërë inspektime në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” me objektivë kontrolli i kompanive radio-taksi të cilët merrnin pasagjer pa porosi si dhe taksit ilegal .

Inspektim në fshatin Gadime-Babush ku është bërë dëmtimi në infrastrukturë rrugore gjatë punimeve ku kompania K-ING sh.p.k ka vendosur gypin e ujës-jellësit për fshatin Babush i cili është urdhëruar të bëhet zhavorrimi aty ku është vendosur gypi, kompania ka zbatuar urdhëresën e dhënë.

Inspektori i ndërtimit- ka realizuar inspektime të vazhdueshme në teren përgjatë zonave urbanistike. Janë inspektuar objekte të cilat posedojnë leje ndërtimi dhe është konstatuar gjendja e tyre me procesverbal si dhe janë realizu vizita inspektuese me kërkesë të ndërtuesve për fazat ndërtimore. Ndaj ndërtimeve të filluara pa leje ndërtimi është konstatuar gjendja me procesverbal dhe është shqiptuar gjobë mandatore.

Drejtoria e Inspektoratit është përgjigjur në të gjitha ankesat e pranuar nga qytetarët.

## **PUNËT DHE AKTIVITETET E REALIZUARA (IMPLEMENTUARA) GJATË PERIUDHËS RAPORTUESE**

Punët dhe aktivitetet e realizuara gjatë muajit mars janë:

Inspektimi dhe parandalimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore dhe inspektimi i objekteve me leje ndërtimi.

Vendosje të shiritave zyrtar.

Inspektimi-kontrollimi i firmave të autobusëve në qytet dhe fshatrat.

Inspektim i rrugëve dhe trotuareve në qytet dhe jashtë qytetit.

Inspektimi i auto-taksive në Aeroportin Ndërkombëtar “Adem Jashari” në Vrellë.

Inspektim për kushtet e LMK-së dhe zbatimin e tyre ndaj investitorëve të objekteve me shumë njësi banimi.

Shqyrtimi i ankesave të qytetarëve në teren me kohë sipas ligjeve dhe rregulloreve komunale.

## STATISTIKAT

Inspektorët	Gjithsej inspekte	Inspekte me procesverbal	Objekte të legalizuara	Fletëparaqitje	Njoftime nga DPMUMM-ja	Njoftime	Vërejtje	Pranim teknik me komision (projekte komunale)	Vendosje të shiritave	Inspekte me miratim	Punë me palë, ankesa, kërkesa	Lendet e pranuar	Lende të pezulluara, ekzekutuara gjyqësore	Konfiskim i targave, librezës dhe kthim	Gjopa mandatore	Njoftim për fillimin e ndërtimeve	Leje ndërtimore	Menaxhim i tregjeve	Aktivendime, ndalesa, urdhëresa	Inspekte për leje Mjedisore Komunale	Inspektim me polici	Inspekte të përbashkëta
Ambienti	37	12				4					5	8			4					2	2	
Ndërtimi	60	17	2		6	4					2	21			1		7					
Trafiku	85	11					12			22	15							10			2	13
Gjithsej	182	40	2		6	8	12			22	22	29			5		7	10		2	4	13

## **DISKUTIMET PUBLIKE**

Diskutime publike nuk kemi mbajtur.

## **TAKIME TË TJERA**

Takimet kryesisht janë mbajtur me qytetarë.

## **SFIDAT**

Inspektimi i ndërtimeve pa-leje ndërtimore.

Ndalimi i hedhjes së mbeturinave inerte në tokat bujqësore, mbrojtja e hapësirave gjelbëruese.

Inspektime të auto-taksive, firmave të autobusëve në qytet dhe në fshatra si dhe inspektimi i taksive ilegal në ANP.

## **REKOMANDIMET**

Rekomandojmë qytetarët të cilët hasin në ndonjë parregullsi e cila trajtohet me kompetencë nga Inspektorati Komunal të na njoftojnë në Drejtorin e Inspektoratit.